

# FLETA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

## Sika® MultiSeal BT

### SHIRIT ADEZIV BUTILIK PËR IZOLIM

#### PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

Sika® MultiSeal BT është shirit izolues vetëngjithës me përbërës gome butilike dhe i mbrojtur nga një fletë metalike e përforcuar me alumin.

#### PËRDORIMET

Izolim dhe riparim kundër depërtimit të ujit në:

- Çati përfshirë edhe fletët metalike të llamarinave
- Fasada
- Pllaka të thyera çatish
- Ulluqe që rrjedhin
- Oxhaqe
- Tubacione sistemesh ajri të kondicionuar
- Karavan dhe rimorkio
- Konteinerë
- Kanale ajrimi

#### KARAKTERISTIKA / AVANTAZHE

- Aplikim shumë i lehtë
- Aplikim me metodën e ftohtë
- I vetëngjithshëm
- Ndërkapje e mirë mbi plastikë, qelq, çelik, polikarbonat, dru dhe shumica e materialeve të zakonshme të ndërtimit
- Ndërkapje e mirë në temperatura të ulëta
- Nuk ndikohet nga kushtet e motit
- Qëndrueshmëri shumë e mirë ndaj nxehtësisë
- Nuk bëhet i rrjedhshëm në temperatura të nxehta
- Nuk njollos me vaj sipërfaqet
- Rezistencë ndaj grisjes, vjetërimit dhe rrezeve UV
- Pa tretës

#### INFORMACIONE MBI PRODUKTIN

<b>Baza kimike</b>	Përbërës gome butilike		
<b>Ambalazhi</b>	<b>Gjatësi për rulon</b>	<b>Gjerësi shiriti</b>	<b>Rulona për kuti</b>
	3 m	100 mm	12
	3 m	150 mm	8
	10 m	100 mm	3
	10 m	150 mm	2
<b>Paraqitja / Ngjyra</b>	Gri, alumin, kafe terracotta		
<b>Jetëgjatësia</b>	36 muaj nga data e prodhimit		
<b>Kushtet e magazinimit</b>	Produkti duhet të ruhet në ambalazhin origjinal, të pahapur dhe të padëmtuar në kushte të thata dhe temperatura midis +5°C dhe +25°C. Referohuni gjithmonë tek ambalazhi.		
<b>Trashësia</b>	~1,0 mm (përfshirë fletën e aluminit)		

## TË DHËNA TEKNIKE

Rezistenca ndaj tërheqjes	Gjatësore:	≥150 N/50 mm	(EN 12311-1)
	Tërthore:	≥150 N/50 mm	
Zgjatimi deri në thyerje	≥ 20 %		(EN 12311-1)
Ndërkapja në shpetëzim	≥ 70 N (në 90°)		(ASTM D 1000)
Temperatura e funksionimit	-30 °C min. / +90 °C max.		

## INFORMACIONE PËR APLIKIMIN

Temperatura e mjedisit	+5 °C min. / +40 °C max.
Temperatura e nënshtresës	+5 °C min. / +40 °C max. Në temperatura nën +10°C shiriti dhe nënshtresa duhet të ngrohen me një ventilator me ajër të nxehtë përpara dhe gjatë aplikimit.

## UDHËZIME APLIKIMI

### PËRGATITJA E NËNSHTRESËS

Nënshtresa duhet të jetë e qëndrueshme, e pastër, e thatë dhe pa kontaminues si pislleqet, vaj, graso, kore çimentoje, izolues të vjetër dhe veshje boje me ngjytje të dobët që mund të ndikojnë ndërkapjen e adezivit / izoluesit. Nënshtresa duhet të ketë rezistencë të mjaftueshme për të përballuar sforcimet që i ushtrohen nga shiriti gjatë lëvizjes. Mund të përdoren teknika pastrimi me furçë teli, bluarja, smerilizimi apo me vegla të tjera mekanike të përshtashme. Pluhuri, materiali i lirë dhe i shkrifët duhet të hiqen plotësisht nga të gjitha sipërfaqet përpara aplikimit të aktivizuesit, prajmerit apo shiritit.

Sika® MultiSeal BT ka në përgjithësi ndërkapje të fortë pa prajmer/ aktivizues mbi shumicën e nënshtresave të thata, të pastra dhe të qëndrueshme. Për rezultate të mira duhet të ndiqet procedura e mëposhtme:

#### Nënshtresa joporoze

Metalet, plastikat, sipërfaqet veshura dhe pllakat me glazurë duhet të pastrohen dhe të trajtohen paraprakisht me Sika®Aktivator-205 me një copë të pastër. Përpara izolimit lejoni kohë tharjeje prej > 15 min (max. 6 orësh).

#### Nënshtresa poroze

Betoni, aerobetoni dhe suvatë prej çimentoje, llaçet, tullat, etj. duhet të jenë lyer me prajmer bituminoz (p.sh. SikaProof® Membrane) me anë të një furçe. Përpara aplikimit të Sika® MultiSeal BT lejoni kohë tharjeje > 1 orë.

### METODA E APLIKIMIT / MJETET

Prisni shiritin në gjatësinë e kërkuar, hiqni filmin dhe ngjeshni shiritin fort mbi nënshtresë dhe një rul.

Për mbivendosje nevojitet ≥ 5 cm.

Performanca e ndërkapjes mund të përmirësohet duke nxehur shiritin Sika® MultiSeal BT gjatë aplikimit.

### MIRËMBAJTJA E MJETEVE

Pastroni të gjitha veglat dhe pajisjen e aplikimit menjëherë pas përdorimit me Sika® Remover-208. Pas tharjes, materiali i ngurtësuar mund të hiqet vetëm mekanikisht. Për pastrimin e lëkurës përdorni Sika® Cleaning Wipes-100.

### KUFIZIME

- Pjesa e sipërme e Sika® MultiSeal BT mund të lyhet me shumicën e sistemeve konvencionale të bojërave
- Të mos përdoret mbi gur natyror
- Kontakti i drejtpërdrejtë me izoluesit e fugave dhe adezivët duhet të shmanget ose të testohet për kompatibilitetin përpara aplikimit
- Mos përdorni Sika® MultiSeal BT për fuga nën presion uji ose për zhytje të përhershme në ujë

### BAZA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

### KUFIZIME LOKALE

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për të dhënat e sakta të produktit.

### EKOLOGJI, SHËNDET DHE SIGURI

Për informacione dhe udhëzime rreth përdorimit, magazinimit dhe asgjësimit të sigurt të produkteve kimike, përdoruesit duhet t' i referohen Fletës me të Dhënat e Sigurisë (Safety Data Sheet, SDS) më të fundit, e cila përmban të dhëna fizike, ekologjike, toksikologjike dhe të tjera që lidhen me sigurinë gjatë përdorimit të produktit.

## SHËNIME LIGJORE

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla sa që asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdolloj afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdolloj forme tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porosinë pranohen sipas kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit, kopjet e të cilave do të jepen sipas kërkesës.

### Sika Albania SHPK

Rruga e Rinasit, Tirana Business Park  
Ndërtesa nr. 7, kati 4  
Tiranë - Shqipëri  
Tel.: +355 4 454 0070  
alb.sika.com  
Email: info@al.sika.com



Fleta e të dhënave të produktit  
Sika® MultiSeal BT  
Shkurt 2019, Botimi 01.01  
020516050000000016

SikaMultiSealBT-sq-AL-(02-2019)-1-1.pdf